

FTESË PËR OFERTË

Kreditimi Rural i Kosovës (KRK) është institucion mikrofinanciar i cili me qëllim të punimit të sporteleve dhe dekorimit të pjesës së brendshme të zyrave të saj për vitin 2026, fton kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për;

PUNIMIN DHE RIPARIMIN E SPORTELEVE TË ZYRAVE

Ftojme kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e tyre për punimin dhe riparimin e sporteleve dhe dekorimin e pjesës së brendshme ballore për zyrat e KRK-së, **për periudhën një vjeçare me mundësi ripërtrirje.**

Oferta duhet të përmbajë çmimin për meter katror apo gjatësi për punët siç vijon:

- punimin e sporteleve dhe tavolinës me sirtar për arkëtar,
- punimi i dekorimit në pjesën e mbrendshme ballore në vazhdim të sportelit (imitim) pa tavolinë pune (paravan),
- punimi i tavolinës së punës së sportelit me sirtar (çmimi për meter),
- tavoline pune (çmimi për meter),
- punimi i sirtarit për tavoline
- punimin e dollapave për sistemin të follderave
- punimi i vitrinave për dokumentacion me dy dyer (gjysma me dyer xhami)
- punimi i vitrinave për dokumentacion me tri dyer (gjysma me dyer xhami)
- punimin e derës lëvizëse pranë sportelit;
- riparimi i sportelit dhe tavoline me sirtar dhe ndërimi i xhamave
- zhvendosjen e sportelit;
- bartjen e sportelit;
- punimi i panelit të drurit dekorues dhe për mbrotje të murit nga dëmtimi me karrige

Materiali i preferuar: diapan, iveric, imitim druri të kombinuara me xham.

Referencë për dizajnin dhe materialin për punimin e sporteleve është dizajni aktual i sporteleve të zyrave të KRK-se.

Çmimet e ofertuara duhet të jenë me TVSH.

Zyrate KRK në të cilat do të punohen sportelet, janë si vijon: Deçan, Ferizaj, Gjakova, Gjilan, Glogoc, Istog, Kaçanik, Klinë, Lipjan, Malisheva, Mitrovicë, Pejë, Podujevë, Prishtinë (dy lokacione zyra qendrore dhe zyra e degës), Prizren, Rahovec, Shtime, Skenderaj, Suhareka, Viti, Vushtrri, Dragash, Kamenice, Fushë Kosovë, Obiliq dhe Gracanice.

Zgjedhja e ofertës me të volitshme do të bëhet në bazë të vlerësimit të ofertës më të volitshme duke u bazuar në kualiteti/çmimi.

Afati për paraqitjen e ofertave është deri me datën **01.12.2025** në adresën e më poshtme:

Kreditimi Rural i Kosovës LLC / Rr. Behije Dashi, Objekti D / 10000 Prishtinë apo përmes email adresës krk_imf@krk-ks.com